

1 E hënë, 14 dhjetor 2020

2 [Konferencë për Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari paraqitet në sallën e gjyqit përmes
5 videolidhjes]

6 --- Fillon në orën 15.00

7 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Mirëdita. Mirë se erdhët të
8 gjithë brenda dhe jashtë sallës së gjykatës.

9 Znj. Sekretare, ju lutem paraqitni çështjen.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita i nderuar
11 Gjykatës. Lënda KSC-BC-2020-05, Prokurori i Specializuar kundër
12 Salih Mustafës.

13 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Ju faleminderit znj. Sekretare.

14 Tani do t'ju kërkoj palëve dhe pjesëmarrësve që të
15 prezantohen. Do të filloj me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëdita i nderuar Gjykatës.
17 Mirëdita të gjithëve. Në gjykatë Prokuroria është e përfaqësuar
18 sot nga z. Jack Smith, Prokuror i Specializuar; nga unë Cezary
19 Michalczuk, prokuror; Silvia D'Ascoli, ndihmësprokurore; dhe
20 Artemis Chatzistavrou, ndihmës për nxjerrjen e materialeve.

21 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Tani ia jap fjalën Mbrojtjes.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës.
23 Mirëdita të gjithëve në gjykatë. Mbrojtja përfaqësohet nga unë
24 Julius von Bone. Unë jam avokati i tij mbrojtës. Z. Mustafa e
25 ndjek seancën e sotme nga objekti i paraburgimit me anë të

1 videolidhjes.

2 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

3 Për hir të procesverbalit, unë jam Nicolas Guillou, Gjykatës
4 i Procedurës Paraprake në këtë çështje.

5 Më 2 dhjetor unë caktova datën e kësaj Konferencë të tretë
6 për Ecurinë e Çështjes. Qëllimi i seancës së sotme është që të
7 rishikohet statusi i çështjes dhe të organizohen shkëmbime midis
8 palëve në mënyrë që të mundësohen përgatitje të shpejta për
9 gjykim.

10 Vë re se palët nuk kanë bërë parashtrime me shkrim, dhe
11 gjithashtu se Mbrojtja nuk ka paraqitur mocione paraprake brenda
12 afatit të paraparë në rregullën 97.

13 Do t'u kërkoj palëve të paraqesin parashtrimet një nga një në
14 bazë të radhitjes së pikave në urdhrin për caktimin e datës, pra,
15 në fillim për nxjerrjen e materialeve, pastaj për hetimet, për
16 pikat juridike dhe faktike për të cilat palët pajtohen, dhe në
17 fund për hapat e mëtejshëm proceduralë.

18 Si zakonisht edhe sot rikujtoj palët që në qoftë se gjatë
19 parashtrimeve do t'i referohen ndonjë informacioni konfidencial,
20 atëherë duhet të më njoftojnë paraprakisht në mënyrë që të shkojmë
21 në seancë të mbyllur ose private.

22 Së pari dua të dëgjoj nga Prokurori për pikën e parë të
23 rendit të ditës, përkatësisht, në qoftë se Prokuroria ka pasur
24 vështirësi në procesin e nxjerrjes së materialeve dhe në qoftë se
25 palët parashikojnë vështirësi të tilla në lidhje me materialet që

1 ende duhet të nxirren.

2 Gjithashtu ftoj Prokurorinë që të na tregojë në qoftë se ka
3 ende në posedim, kontroll, ose dijeni të vetë prova shfajësuese që
4 duhet t'i dorëzohen Mbrojtjes në pajtim me rregullën 103.

5 Urdhëroni z. Prokuror.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ju faleminderit. Përpara se të
7 kaloj te pikat që i përmendët, dua të paraqes disa parashtime
8 paraprake.

9 Në fillim dua të shpreh qëndrimin e Prokurorisë në lidhje me
10 bazën për këtë proces paragjyqësor duke qenë se procesi i
11 nxjerrjes së materialeve është nga fundi.

12 Prokurori synon që të përfundojë fazën paragjyqësore të
13 procedurës nga fillimi i vitit të ardhëm dhe të kalojë në fazën
14 gjyqësore sa më shpejt që është e mundshme, dhe pas kësaj dhe të
15 dorëzojë dosjen e vetë paragjyqësore. Duke pas këtë që e thashë
16 parasysh, duhet të gjithë të kemi si datë të synuar për fillimin e
17 gjykatës dikund marsin 2021.

18 Për sa i përket problemeve lidhur me nxjerrjen e materialeve,
19 për momentin nuk kemi probleme apo vështirësi të tilla. Do t'ju
20 rrëfej në pika të shkurtra se çfarë kemi nxjerrë nga materialet
21 nga Konferenca e fundit për Ecurinë e Çështjes.

22 Nga 16 nëntori i kemi dorëzuar Mbrojtjes materialet brenda
23 rregullës 102(1)(b), materiale që nuk kërkonin redaktim, dhe ky
24 grup materialesh përmban gjithsej 369 dokumente, përkatësisht 1226
25 faqe.

1 Më pas, më 1 dhjetor, ZPS-ja gjithashtu i dorëzoi Mbrojtjes
2 materiale sipas rregullës 102(1)(b) në lidhje me dëshmitarët, të
3 cilat kërkonin redakte. Bëhet fjalë për 139 dokumente,
4 përkatësisht 1991 faqe.

5 Gjithashtu në përputhje me vendimin tuaj për nxjerrjen e
6 materialeve, Mbrojtjes iu dorëzua dhe një njoftim i hollësishëm
7 lidhur me provat sipas rregullës 102(3). Bëhet fjalë për gjithsej
8 390 dokumente. Kjo është një listë që përmban pra, 390 dokumente
9 në gjuhën anglishte, shqipe dhe serbishte.

10 Pas nxjerrjes së këtyre materialeve, Prokurori i dorëzoi
11 Mbrojtjes një e-mail, ku shpjegoi përmbajtjen e çdo grupi
12 materialesh të dorëzuara.

13 Siç thashë edhe më herët, nuk kemi pasur vështirësi deri më
14 tani, nuk presim që të kemi vështirësi. Kemi përmbushur detyrimet
15 tona të nxjerrjes së materialeve.

16 Nuk e di nëse doni të vazhdoj me materialin shfajësues që
17 kemi në posedim apo kontroll?

18 Meqë po, po vazhdoj. Në këtë moment, i nderuar Gjykatës,
19 Prokurori ka ende materiale shfajësuese nën kontroll dhe posedim
20 të vetin, megjithatë procedura e dorëzimit po shkon dhe zhvillohet
21 shpejt dhe në vazhdimësi materialet që do të dorëzohen, në bazë të
22 rregullës 103, të mëtejshme, pra, do t'i dorëzohen Mbrojtjes besoj
23 nga fundi i kësaj jave.

24 Po i kontrollojmë të gjitha materialet në lidhje me prova
25 shfajësuese. Besoj që kontrollimi i materialit do të nxjerrë -- do

1 të shkojë drejt nxjerrjes së mëtejshme të materialeve të tilla
2 sipas rregullës 103.

3 Ndoshta do të ketë nevojë, i nderuar Gjykatës, për një vendim
4 në lidhje me redaktimet. Ne do të bëjmë një kërkesë, dhe këtë
5 kërkesë do t'jua paraqesim nga gjysma e janarit. Nuk e dimë datën
6 e saktë, por e kemi ndërmend që të vazhdojmë me nxjerrjen e
7 materialeve sa më shpejt që të jetë e mundshme.

8 Gjithashtu kemi edhe veprimtari të tjera që po i kryejmë për
9 momentin, si p.sh., transkriptimin e intervistave. Duhet ndoshta
10 që të shikojmë përmbajtjen e tyre dhe të marrim vendim në qoftë se
11 ato materiale duhet të dorëzohen me ose pa redakte.

12 Sido që të jetë, ne Mbrojtjes do t'ia dorëzojmë të gjitha
13 materialet që i kemi, brenda rregullës 103, sa më shpejt që të
14 jetë e mundshme dhe sa më shpejt që të identifikohet një material
15 i tillë.

16 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Do t'ju ndërpres këtu. Të
17 dëgjojmë njëherë nga z. Von Bone për punën e nxjerrjes së
18 materialeve, pastaj do të kalojmë te pika 2 në lidhje me hetimet.

19 Urdhëroni z. Von Bone.

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Kemi marrë
21 materialet nga Prokuroria, ku përfshihet edhe një listë mjaft e
22 gjatë. Ndoshta më vonë do të doja -- do të kërkoj që ta diskutoj
23 atë listë në seancë të mbyllur.

24 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] A keni pasur ndonjë vështirësi,
25 apo keni ndonjë problem në lidhje me materialet që keni marrë?

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, asnjë çështje në veçanti, asnjë
2 vështirësi në veçanti, por vetëm një çështje konkrete që dua ta
3 trajtoj në seancë të mbyllur.

4 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Von Bone.

5 Atëherë, tani i kthehem përsëri Prokurorit lidhur me pikën e
6 dytë të rendin të ditës, statusi i hetimeve në kryerje e sipër.
7 Veçanërisht, në qoftë se i keni përfunduar hapat hetimorë të
8 përmendur në Konferencën e fundit? Në qoftë se mund të na jepni
9 një datë të përafërt se kur do të përfundojnë këto hetime, dhe në
10 qoftë se jeni në pozitë të na konfirmoni që dosja juaj
11 paragjyqësore dhe materiali tjetër, në bazë të rregullës 94(4), do
12 të mund të dorëzohet nga fundi i shkurtit 2021?

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni, do t'i
14 trajtoj këto dy pika veç e veç. Do të filloj me hetimet.

15 Në seancën e fundit në lidhje me Ecurinë e Çështjes, ne thamë
16 që na kanë mbetur edhe disa hapa hetimorë për t'i ndërmarrë. Pjesa
17 më e madhe e tyre u ndërmorën. Nuk ka përfunduar plotësisht
18 hetimi, ka mbetur edhe një numër i vogël hapash që duhet t'i
19 ndërmarrim në vazhdimësi, në vijimësi të disa hetimeve që i kemi
20 bërë.

21 Gjithsesi, sikurse thamë në Konferencën e fundit për Ecurinë
22 e Çështjes, edhe në qoftë se na ka mbet ndonjë punë për të bërë,
23 ajo punë nuk do të ndikojë në procesin e nxjerrjes së materialeve
24 dhe ne do t'u përmbahemi afateve që i keni caktuar ju. Gjithashtu
25 këto hapa të mbetur të hetimeve nuk ndikojmë në përgatitjen e

1 çështjes për gjykim.

2 Sikurse thashë, mendoj që gjykimi mund të fillojë në mot, në
3 një datë më të hershme. Dua të theksoj se hetimet që i kryen zyra
4 jonë nuk janë vetëm në lidhje me këtë çështje gjyqësore por edhe
5 me çështje të tjera gjyqësore, prandaj kjo mund të ndikojë në një
6 masë të konsiderueshme edhe në këtë çështje. Duhet ta mbajmë, pra,
7 parasysh këtë fakt kur bëjmë fjalë për detyrimet e nxjerrjeve të
8 materialeve Mbrojtjes.

9 Për këto arsye nuk mund t'ju them -- në këtë moment nuk mund
10 të them se i kemi përfunduar të gjitha hapat sepse, siç thashë,
11 nuk bëhet fjalë vetëm për një çështje gjyqësore por më shumë
12 çështje. Ne gjithsesi do të vazhdojmë që t'i përmbushim detyrimet
13 tona të nxjerrjes së materialit, dhe kjo vlen edhe për materialet
14 e reja.

15 Kur është fjala për dosjen paragjyqësore, tani që procesi i
16 nxjerrjes së materialeve është në një fazë më të avancuar, mund
17 t'ju raportoj me një saktësi më të madhe për momentin se kur mund
18 të dorëzojmë dosjen tonë paragjyqësore. Ne do ta dorëzojmë këtë
19 dosje më 15 shkurt të vitit të ardhshëm. E kam fjalën jo vetëm për
20 dosjen paragjyqësore por edhe për materialet brenda rregullës
21 95(4). Ju faleminderit.

22 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z. Prokuror. Kam
23 marrë shënim datën 15 shkurt.

24 Z. Von Bone, tani ju lutem të na përditësoni lidhur me
25 hetimet e Mbrojtjes. Në Konferencën e fundit, ju thatë që

1 planifikonit të shkonit në Kosovë në fillim të dhjetorit të
2 këtij viti. A mund të na thoni, ju lutem, se edhe sa kohë ju duhet
3 për t'i përfunduar veprimtaritë hetimore?

4 Dhe gjithashtu ftoj Mbrojtjen që të më informojë në qoftë se
5 ka ndërmend që të bëjë njoftim për alibi, ose për arsye të tjera
6 që përjashtojnë përgjegjësi penale, në bazë të rregullës 95(5),
7 dhe/ose a ka ndërmend të bëjë kërkesë për mundësi hetimore unike,
8 në bazë të rregullës 99(1).

9 Urdhëroni z. Von Bone.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Ju faleminderit i nderuar Gjykatës.
11 Dua të ngre një çështje në lidhje me materialet që më janë
12 dorëzuar nga Prokuroria. Që të jemi të sigurt dua që këtë ta bëj
13 në seancë të mbyllur, sepse mund të përmend emra dhe këtë nuk dua
14 ta bëj në seancë publike.

15 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Në rregull z. Von Bone, do të
16 kalojmë në seancë të mbyllur deri në një njoftim të mëtejshëm.
17 Kërkoj nga sekretari që të kalojmë në seancë të mbyllur. Tani ju
18 lutem më tregoni se kur jemi realisht në seancë të mbyllur, që të
19 vazhdojmë me parashtrimet e z. Von Bone.

20 [~~Seancë e mbyllur~~] Sipas urdhrit gojor të datës 05/03/2021
riklasifikuar si PUBLIKE

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, jemi në
22 seancë të mbyllur.

23 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Z. Von Bone, fjala për ju.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës.

25 Çështja është si më poshtë: Ne kemi marrë një listë shumë të

1 gjatë të dokumenteve të cilat janë nxjerrë nga Prokuroria. Jo të
2 gjitha këto dokumente në fakt janë nxjerrë nga Prokuroria, pra,
3 nuk i është dhënë Mbrojtjes një listë e plotë e këtyre dokumenteve
4 të cilat janë pjesë e listës, megjithatë kam një konstatim të
5 përgjithshëm që do të doja të sillja në vëmendjen tuaj.

6 Në qoftë se e shoh siç duhet, sa i takon dëshmitarëve, shoh
7 disa dëshmitarë të cilët janë njerëz të identifikuar në atë listë,
8 janë njerëz të cilët janë përmendur me pseudonime dhe njerëz ose
9 persona të cilët nuk kanë emër, d.m.th., emrat e të cilëve nuk
10 janë dhënë. Sa i takon pseudonimeve, unë kam identifikuar 13
11 pseudonime. Dhe pyetja që shtrohet lidhur me këtë është, në qoftë
12 se në deklaratat të mëparshme të të gjithë këtyre personave -- dhe
13 sigurisht që unë mund të jap të gjithë pseudonimet e hasura në të
14 gjitha dokumentet që më janë dhënë, por mund të them për momentin
15 që bëhet fjalë për 13 pseudonime. Fillojnë me W0393 //siç u
16 përkthye// dhe lista pastaj vazhdon e vazhdon më tej.

17 Dhe mendoj se është shumë e rëndësishme për Mbrojtjen, dhe
18 nuk është e rëndësishme vetëm për Mbrojtjen por edhe për Trupin
19 Gjykues në përgjithësi, që të identifikohet në qoftë se këta
20 persona, këta individë kanë dhënë dëshmi në çështje në ndryshme,
21 d.m.th., kjo është pyetja e parë që duhet të sqarohet. Duhet të
22 shihet në qoftë se dëshmitë e tyre mund të merren, në qoftë se
23 është rasti që ata kanë dhënë dëshmi të mëparshme, në kuadrin e
24 çështjeve të mëparshme, dhe mund të ndodhë gjithashtu që
25 pseudonimet të mund të prezantohen, ose mbase janë prezantuar si

1 palë të dëmtuara në çështje të mëparshme.

2 Ne mendojmë se është shumë e rëndësishme për Gjykatën për të
3 përcaktuar besueshmërinë e njerëzve. Në qoftë se unë lexoj disa
4 prej deklaratave të tyre, konstatohet, vihet re se Prokuroria vë
5 në -- d.m.th., pyet një dëshmitar të caktuar sa i takon një
6 dëshmie të mëparshme, por ndërkohë nuk kam pasur mundësi që
7 dëshminë e mëparshme ta lexoj apo ta shoh në dokumentacionin që më
8 është dhënë nga Prokuroria. Mendoj se është shumë e rëndësishme të
9 sqarohet kjo çështje, sepse jam i sigurt që nuk do të jetë rasti i
10 parë apo i fundit kur do të shikojmë persona të caktuar të cilët
11 japin dëshmi në -- dhe që kanë dhënë dëshmi edhe në çështje të
12 mëparshme. Kështu që mendoj që është e rëndësishme për
13 besueshmërinë e këtyre dëshmitarëve që të kemi dëshmitë e plota të
14 tyre, pra, të shikojmë në përgjithësi se çfarë kanë deklaruar ata.

15 Kjo mund të lidhet po ashtu me njerëzit të cilët janë

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR] do të

19 na dalin shpesh në këtë çështje dhe mbase janë të justifikuar në
20 çështje të tjera të mëparshme.

21 Pra, nuk e dimë në qoftë se në rastet, në çështjet e
22 mëparshme ata kanë qenë të justifikuar, d.m.th., ka qenë e
23 justifikuar që të përmendin emrin e tyre, por do të duhet të dimë
24 se çfarë lloj gjykimi është marrë në çështje të mëparshme, apo
25 cili ka qenë vendimi sa i takon dhënies së dëshmisë nga personat

1 ose individët specifikë, qoftë për një çështje të caktuar apo për
2 çështje në përgjithësi. Mbrojtja beson se kjo është pa diskutim
3 shumë e rëndësishme për t'u sqaruar nga Gjykata dhe për të
4 përcaktuar rreth këtyre dëshmitarëve.

5 Po ashtu, kam identifikuar edhe dy dëshmitarëve të misioneve
6 të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Nuk janë dhënë me emra, po
7 thjesht janë identifikuar si dëshmitari A dhe dëshmitari B. Nuk i
8 kam lexuar ende dëshmitë e këtyre individëve, por sërish dua të
9 them që këta individë -- pra, duhet të dimë rreth tyre në qoftë se
10 ata kanë dhënë deklaratat të mëparshme ose në qoftë se kanë
11 dëshmuar.

12 Dhe për këto tri grupe, d.m.th., për persona të cilët janë
13 dhënë me pseudonime, për ata që janë dhënë me emra, dhe për
14 dëshmitarët A dhe B që përmenda më përpara, pra, është e
15 rëndësishme që të dihet në qoftë se kanë dhënë deklaratë në kuadër
16 të një procesi gjyqësor të mëparshëm apo në procesin e një hetimi.

17 Nga dokumentacioni i përgjithshëm unë kam identifikuar të
18 paktën 232 dokumente që do të duhet që të inspektohen më tej, ose
19 të paktën të shqyrtohen, të shikohen pak me më shumë kujdes.
20 Mendoj se është e rëndësishme që ne të dimë p.sh., se kur shohim
21 se është ndaluar një hetim, duhet të dimë se kundër kujt ishte
22 bërë një hetim i tillë. Po ashtu duhet të dimë se cilët janë
23 dëshmitarët të cilët janë mbështetur hetimet përkundrejt një të
24 dyshuari të caktuar në çështjen X. Për shembull, deri tani unë kam
25 parë një vendim mbi dikë i cili ndoshta mund të ketë qenë i

1 dyshuar, nuk është dhënë me emër me mbiemër, por megjithatë për
2 mua nuk ishte e qartë se cila ishte baza që kishte çuar në dënimin
3 e këtij individit.

4 Edhe njëherë më lejoni të them që mund të jenë persona të
5 cilët mund të kenë dalë në çështje dhe të mëparshme, dhe kemi parë
6 dhe nga procedurat e mëparshme në Tribunalin e Ruandës apo në
7 ICTY, kur ka ndodhur kur persona, individë të dalin në shumë
8 çështje dhe ku mund të japin deklarata të ndryshme, ose mbase mund
9 të japin të njëjtën deklaratë në lidhje me të dyshuar të ndryshëm.

10 Pra, gjatë përvojës së gjatë në këto çështje, kjo është diçka
11 që del herë pas herë në pah, kështu që është diçka e rëndësishme
12 për t'u përcaktuar. Kështu që do të doja t'i kërkoja Prokurorisë
13 të më thoshte në qoftë se dëshmitarët e identifikuar me
14 pseudonime, ose që nuk janë dhënë me -- janë dhënë me emra ose si
15 dëshmitarë A apo B, do të doja të dija në qoftë se ata kanë bërë
16 deklarata në kuadrin e proceseve të mëparshme gjyqësore, apo kanë
17 dhënë thjesht deklarata përpara policisë. Në qoftë se është ky
18 rasti, pra, mendoj që Mbrojta ka të drejtë që të kërkojë që
19 materiali t'i ridorëzohet edhe njëherë Gjykatës dhe të bëhet
20 sërish pjesë e të gjithë dosjes së çështjes.

21 Në qoftë se dëshironi, pa diskutim që unë mund t'i referohem
22 edhe pseudonimeve. Në qoftë se nuk dëshironi, mund ta lë me kaq.
23 Pra, nuk dëshiroja që ta dorëzoja këtë si dokument sepse nuk e
24 kisha idenë sesi mund të klasifikohet në publik, edhe nuk është
25 qëllimi im në asnjë mënyrë që të cenoj ndonjë hetim, apo të nxjerr

1 ndonjë person përmes përdorimit të pseudonimeve. Nuk jam i sigurt
2 në qoftë se dëshmitarët po e shohin apo po e ndjekin këtë proces
3 gjyqësor, dhe është në interesin e të gjithëve që të sigurohemi që
4 të përcaktojmë në një pikë të caktuar besueshmërinë e tyre. Dhe
5 mendoj që kjo do të ishte një pikë e rëndësishme e zhvillimeve
6 sot.

7 Ndonjëherë shohim që ka njerëz që prezantohen si palë të
8 dëmtuara në një çështje të caktuar. Ndërkohë unë nuk kam parë
9 pyetje në lidhje me këtë element, të paktën në deklaratat e
10 dëshmitarëve që kam lexuar, që kam kaluar deri tani. Por
11 pavarësisht kësaj, mendoj që është e rëndësishme që të përcaktojmë
12 se çfarë dëmtimesh pretendon një person i caktuar. D.m.th., cilat
13 janë shkaqet që dikush të pretendojë që ka qenë palë e dëmtuar në
14 kuadrin e një çështje të caktuar. Dhe kjo në vetvete do të
15 përcaktojë afatet kohore dhe lokacionin, vendndodhjen e këtij
16 dëshmitari në një çështje të caktuar, edhe që mund të jetë në
17 kundërshtim ose jo me besueshmërinë e përgjithshme të individit në
18 fjalë. Edhe mendoj që është e rëndësishme që të përcaktohet kjo
19 gjë. Kam biseduar me klientin tim lidhur me deklaratat dhe vërtetë
20 do të dëshironim të kishim në dispozicion këto deklarata për
21 momentin.

22 Pra, kjo është çështja që dëshiroja që ta diskutonim me dyer
23 të mbyllura. Mendova që do të ishte më mirë që ta diskutonim me
24 dyer të mbyllura, por gjithsesi në qoftë se ju mendoni që do të
25 jetë më mirë që të vijojmë ndryshe, nuk kam kundërshtim lidhur me

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore
Konferencë për Ecurinë e Çështjes (~~Seancë e mbyllur~~)
Sipas urdhrorit gojor të datës 05/03/2021 riklasifikuar si PUBLIKE

Faqe 14

1 të. Atëherë, po pres për përgjigjen tuaj tani dhe pastaj mund të
2 kalojmë në seancë me dyer të hapura dhe të flas më tej për temat
3 që më kërkuat të shprehesha.

4 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Po. Faleminderit. Faleminderit
5 shumë z. Von Bone.

6 Tani përpara se t'i jap fjalën Prokurorisë, do të doja t'u
7 kërkoja palëve vendimin që kam nxjerrë për masat mbrojtëse, dhe
8 këtë në fakt e kam trajtuar pjesërisht në vendimin tim.

9 Prokuroria, e keni ju fjalën në përgjithësi sepse nuk është
10 se po flasim për një dëshmitar të caktuar, specifik, por po flasim
11 për çështje në parim. Fjala për ju.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Qëllimi i listën që ju kemi vënë në
13 dispozicion, në përputhje me rregullën 102(2), është që Mbrojtjes
14 t'i japim një ide se çfarë kemi në përgjithësi në posedimin tonë
15 dhe çfarë materialesh apo çfarë provash ne kemi si Prokurori. Kjo
16 është lista e plotë e të gjitha gjërave që ne kemi deri tani. Sa i
17 takon materialeve që kemi për këtë çështje, për këtë të pandehur,
18 kemi këtë listë që i kemi dhënë Mbrojtjes.

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore
Konferencë për Ecurinë e Çështjes (~~Seancë e mbyllur~~)
Sipas urdhrorit gojor të datës 05/03/2021 riklasifikuar si PUBLIKE

Faqe 15

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR] D.m.th., me fjalë të tjera, çdo gjë është në
7 dispozicion të Mbrojtjes.

8 Qëllimi kryesor i kësaj liste është që Mbrojtja të na
9 drejtohet. Dhe sigurisht që ka një afat kohor që duhet të
10 respektohet, dhe kam përshtypjen që afati kohor është 15 janari.
11 Dhe pas këtij momenti Mbrojtja duhet të konstatojë listën e
12 dokumenteve të propozuara që qëndrojnë pas listën që ai do të
13 shqyrtojë në kuadër të diskutimit që po realizon tani. Pra, çfarë
14 dokumentesh të tjera ka përtej listës, d.m.th., është e
15 rëndësishme që Mbrojtja të na japë këtë listë.

16 Dhe do ta inkurajoja Mbrojtjen që ta shikonte me kujdes
17 listën, dhe të vinte te ne me një listë të dokumenteve të tjera
18 shoqëruese shtesë që ai dëshiron që të këtë.

19 Kur i takon çështjeve të tjera, sepse kolegu im përmendi disa
20 pika, njëra prej këtyre pikave është besueshmëria e dëshmitarëve
21 në përgjithësi. Mendoj që momenti për të testuar besueshmërinë e
22 dëshmitarëve nuk është kjo fazë e procedimit por është procesi i
23 mirëfilltë gjyqësor.

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore
Konferencë për Ecurinë e Çështjes (~~Seancë e mbyllur~~)
Sipas urdhrorit gojor të datës 05/03/2021 riklasifikuar si PUBLIKE

Faqe 16

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 Nuk e di, a ka ndonjë gjë tjetër që do të donit, i nderuar
19 avokat mbrojtës, që të sqarohej? Mbase kam harruar diçka.

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo. [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]por

5 ajo çfarë mund të bëhet këtu është që në qoftë se duam të kemi një
6 proces gjyqësor i cili në një pikë të caktuar kohe do të na duhet
7 -- d.m.th., në qoftë se do të shfaqet kjo çështje, në qoftë se kjo
8 do të çonte në zgjatjen e procesit gjyqësor. Mendoj që është me
9 vlerë që këtë përcaktim, këtë sqarim ta bënim tani, më shumë sesa
10 të hasemi me çështje të tilla dhe të na duhet t'i zgjidhim ato
11 gjatë procesit gjyqësor. D.m.th., logjika këtë të tregon.

12 Por sa i takon palëve të dëmtuara, nuk është ndonjë problem
13 shumë i madh në qoftë se ata, d.m.th., kanë kërkuar që të jenë në
14 statusin e palëve të dëmtuara në kuadër të kësaj çështje, ose në
15 qoftë se kanë kërkuar, le të themi, statusin e palës së dëmtuar në
16 një çështje tjetër. Dhe në qoftë se ka qenë ky rasti, atëherë cili
17 ka qenë dëmtimi i pretenduar prej tyre, se mund të ndodhë që
18 dëmtimi mund të jetë shkaktuar nga një incident tërësisht tjetër.

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 Sigurisht që do të ishte mirë, siç e thashë dhe më përpara,
4 që ta trajtojmë këtë dhe ta sqarojmë këtë çështje tani përpara,
5 paraprkisht pra, sesa gjatë procesit gjyqësor. D.m.th., kjo ishte
6 ideja ime, përse e ngrita këtë çështje.

7 Sa i takon pseudonimit që kam -- pseudonimeve që kam
8 identifikuar, aktualisht nuk jam në gjendje për të përcaktuar në
9 qoftë se deklaratat e mëparshme të tyre janë të plota apo jo, por
10 Prokuroria tha sot që deklaratat janë të plota. Dhe në qoftë se
11 është kështu, atëherë nuk do të kemi, le të themi, surpriza gjatë
12 procesit gjyqësor. Thjesht doja të dija në qoftë se Prokuroria
13 mund të bëjë një vlerësim të fundit lidhur me këtë, dhe në qoftë
14 se do t'u duhet punë shtesë apo jo.

15 Sa i takon dokumentacionit që kam marrë, unë kam identifikuar
16 të paktën 232 materiale që do të doja t'i inspektoja në më tepër
17 thellësi gjatë muajve në vijim. Dhe, pra, ndonjëherë procesi
18 kërkon pak më shumë kohë, ndonjëherë është më i shpejtë, kështu që
19 do të na duhet ca kohë edhe sa i takon shqyrtimit të materialeve
20 që janë vënë në dispozicion. Faleminderit.

21 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Z. Prokuror, keni për të shtuar
22 diçka?

23 Z. Prokuror urdhëroni.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] S'kam shumë për të thënë në
25 përgjigjen time. Sikurse thashë edhe më herët, pasi që t'i

1 kontrolloj dokumentet dhe t'i shqyrtoj ato, dokumentet nga listat,
2 ai do të dijë se cilët dëshmitarë kanë dhënë deklaratat në të
3 kaluarën dhe cilët jo. Kjo është vetëm një listë thjesht.

4 Për mendimin tonë, Mbrojtja duhet t'i lexojë dokumentet dhe
5 do të marrë informacionin e duhur pasi t'i ketë lexuar, që mos ta
6 zgjasim shumë këtë pikë në këtë seancë.

7 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

8 Z. Von Bone, në pajtim me vendimin tim në lidhje me nxjerrjen
9 e materialeve, mendoj që hapi në vijim duhet të jetë që të
10 kërkohet dorëzimi i dokumenteve deri të premtën më 8 janar.
11 Ndoshta një pjesë të përgjigjeve që kërkoni do t'i merrni pasi t'i
12 keni lexuar dokumentet. Ta kalojmë këtë pjesë dhe këtë hap, dhe në
13 qoftë se edhe më pas e shikoni të nevojshme që të bëni një
14 kërkesë, atëherë këtë mund ta bëni.

15 Zakonisht besueshmëria e dëshmitarëve vlerësohet gjatë vetë
16 gjykimit, dhe kjo është një prej funksioneve kryesore të gjykimit.
17 Kjo nuk duhet të bëhet në fazën paraprake, edhe pse është mirë
18 çdoherë që të anashkalohen debatetime të gjata.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Arsyeja pse e ngrita këtë pikë është
20 se ndonjëherë ndodh që Prokurori të nxjerrë nga lista një
21 dëshmitar. Prandaj unë pajtohem me ju se vendimin përfundimtar e
22 merr Trupi Gjykses, por i takon Prokurorisë që të vendosë në qoftë
23 se do të vazhdojnë apo jo me një dëshmitar, d.m.th., në qoftë se
24 do të mbështeten në dëshminë e atij dëshmitari ose jo për çfarëdo
25 arsye. Prandaj edhe unë e ngrita këtë çështje në këtë moment, në

1 mënyrë që nëse Prokuroria ndryshon mendimin e vetë lidhur me
2 numrin e dëshmitarëve, atëherë t'i shmangemi debatimeve të
3 mëtejshme.

4 Nuk e kam të qartë dhe dua të dëgjoj nga Prokuroria, sepse
5 për mendimin tim, duke u nis nga lista e dokumenteve edhe pse
6 është e gjatë, ka dokumente që nuk janë dorëzuar, me aq sa di unë.
7 Dhe kërkoj falje nëse e kam gabim.

8 Dua të di nga Prokuroria në qoftë se deklaratat e
9 dëshmitarëve që janë -- që kanë dhënë ata dëshmitarë më përpara,
10 mesa di Prokuroria, a janë komplete, të përfunduara, apo duhet të
11 kërkojmë, identifikojmë pika të reja?

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Lista mbi të cilën mbështetet
13 Prokuroria në këtë çështje, me aq sa dimë ne, përfshin të gjitha
14 deklaratat e këtyre personave.

15 Ka disa dëshmitarë megjithatë mbi të cilët ne nuk
16 mbështetemi, por ne nuk i kemi hequr ata dëshmitarë nga lista.
17 Sikurse thashë, të gjitha këto dëshmi janë në listë. Për shembull,
18 në këtë listë keni disa njerëz që janë të përmendur me emra dhe
19 mbiemra, p.sh., këta persona janë të themi, mund të jenë persona
20 që i kemi intervistuar në të kaluarën, por mbi të cilët nuk do të
21 mbështetemi. Thjesht si shembull po e them këtë.

22 Me sa dimë ne, lista që e kemi dorëzuar më 1 dhjetor përfshin
23 informacionin që është i rëndësishëm për çështjen e Prokurorisë
24 dhe për Mbrojtjen, pra, për të dy palët në këtë procedurë, në
25 mënyrë që Trupi Gjykses më vonë të mund të sjellë vendimet e

1 duhura lidhur me faktet.

2 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Z. Von Bone, a i përgjigjet kjo
3 pyetjes suaj?

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Do të ngre dhe një pjesë të vogël për
5 një minutë. Ka disa emra të përmendur në listë, por lista në
6 lidhje me këto emra nuk është e qartë. Bëhet fjalë për disa emra
7 paraburgimi i të cilëve ishte ndërprerë.

8 Pyetja është se ku janë mbajtur në ndalim këta njerëz, për
9 çfarë arsyes janë mbajtur në ndalim?

10 Pjesa tjetër e kësaj pike është kjo; dëshmitarët që kanë
11 pseudonime. Në lidhje me ta, Mbrojtja do të dijë në qoftë se
12 Prokuroria ka bërë hetime lidhur me të kaluarën kriminale apo
13 penale të tyre. Në qoftë se ka bërë kërkesa të tilla pranë një
14 institucioni autoritativ. Thjesht duam të dimë në qoftë se në
15 mesin e këtyre personave ka njerëz me të kaluar -- që kanë qenë të
16 dënuar në të kaluarën.

17 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Ju faleminderit Mbrojtës.

18 Z. Prokuror, shpejt e shpejt përgjigjuni që të kalojmë në
19 seancë të hapur.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Sipas ligjit, Prokuroria ka për
21 detyrë të mbledhë të gjitha dokumentet, materialet që janë në dobi
22 apo kundër çështjes së saj. Dhe ne po mbledhim të gjitha këto
23 dokumente. Në to ka edhe material shfajësues. Në qoftë se mungon
24 ndonjë gjë që i duhet Mbrojtjes, atëherë ky është një moment i
25 përshtatshëm që Mbrojtja të bëjë hetimet e veta në qoftë se i

1 gjykon të nevojshme në këtë fazë të procedurës.

2 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

3 Urdhëroni z. Von Bone.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Edhe pse është e vështirë -- Është e
5 vështirë që të hetohet në qoftë se ka një dëshmi penale për një
6 person, në qoftë se ai person nuk përmendet me emër dhe mbiemër
7 por vetëm me pseudonim. Kjo shkakton një ndërlikim për Mbrojtjen.
8 Ne nuk jemi në këtë moment në gjendje të dimë se cilët janë të
9 gjithë dëshmitarët, por thjesht është relevante që të dihet në
10 qoftë se për këta ka dëshmi penale ose jo. Është e pamundshme për
11 Mbrojtjen që të bëjë hetime kur ka vetëm pseudonime.

12 Thjesht dua të di në qoftë se Prokuroria është e gatshme të
13 bëjë diçka më shumë për sa që i kërkohet asaj në lidhje me këtë
14 aspekt, sepse ne nuk mund të bëjmë asgjë.

15 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Z. Prokuror.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Pajtohem se dëshmia penale është e
17 rëndësishme për Mbrojtjen, edhe për Prokurorinë për atë punë. Mund
18 të bëjmë një kontrollim të mëtejshëm. Por përsëri nxis Mbrojtësin
19 që të kryejë hetimet e veta. Ne do ta kontrollojmë edhe njëherë
20 këtë aspekt të veçantë.

21 Por me aq sa dimë ne, nuk ka diçka që është relevante për
22 këtë çështje. Por do ta kontrollojmë këtë pikë, duke mbajtur
23 parasysh faktin se disa prej këtyre dëshmitarëve janë dëshmitarë
24 të mbrojtur. Dhe gjithsesi Mbrojtja nuk ka as emrin e atyre
25 dëshmitarëve për të bërë kërkesë pranë autoriteteve përkatëse në

1 Kosovë lidhur me dëshminë penale kundër atyre personave.

2 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

3 Z. Von Bone, keni diçka për të shtuar?

4 Atëherë, në vijim ju duhet t'i jepni Prokurorit një listë
5 deri më datën 8 janar, dhe të zhvilloni një diskutim lidhur me
6 këtë pikë të fundit.

7 Gjithashtu ju rikujtoj se dëshmitarët e mbrojtur janë të
8 mbrojtur në bazë të një vendimit tim dhe këto masa mund të
9 ndryshohen vetëm me një vendim timin. Këtë gjë nuk mund ta bëjë
10 vetë Prokuroria.

11 Në qoftë se nuk kanë palët asgjë për të shtuar, atëherë do të
12 kalojmë në seancë publike.

13 Znj. Sekretare, ju lutem vazhdoni.

14 [Seancë e hapur]

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

16 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Sekretare.
17 Jemi tani në seancë publike.

18 Z. Von Bone, tani do t'jua jap fjalën juve në mënyrë që të na
19 përgjigjeni në lidhje me pyetjet që ju bëra më herët. Pra, për
20 statusin e hetimeve, për njoftimin për alibi, ose për arsye të
21 tjera që përjashtojnë përgjegjësi penale, dhe në qoftë se do të
22 bëni kërkesë për mundësi hetimore unike.

23 Urdhëroni.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Për të gjitha këto aspekte që i
25 përmendët, i nderuar Gjykatës, nuk kemi përgjigje në këtë moment.

1 Për sa i përket pikës F(1) dhe pikës F(2), përgjigja ime është që
2 nuk synojmë ta bëjmë atë parashtrim.

3 Dhe pak përpara se të fillonte seanca e sotme, dëgjova në
4 lajme sot që do të bëhet një mbyllje e plotë lidhur me pandeminë
5 në Holandë, që do të hyjë në fuqi sonte në orën 12.00 të natës dhe
6 do të vazhdojë deri më 19 janar. Nuk e di se në çfarë mase kjo
7 masë do të ndikojë mbi aktivitetet tona, por siç ju thashë, do të
8 ketë një mbyllje të plotë, dhe kjo padyshim që do t'i kufizojë
9 mundësitë e Mbrojtjes për t'i kryer hetimet e veta apo për të
10 udhëtuar në Kosovë.

11 Kaq kam për të thënë lidhur me statusin e hetimeve të
12 Mbrojtjes. Sa do të zgjasin ato? Do të kisha thënë përafërsisht
13 rreth nëntë muajve së paku.

14 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Von Bone.

15 E kam të qartë se ndoshta do të kufizoheni për shkak të
16 masave lidhur me pandeminë. E kam të qartë se ndoshta nuk e keni
17 të gjithë informacionin që ju duhet se kur do të përfundoni
18 hetimet, por do t'ju këshilloja që të vazhdoni, dhe të filloni të
19 vazhdoni hetimet sa më shpejt që është e mundur në mënyrë që të
20 mos ta zgjasim pa nevojë këtë fazë paraprake. Me të pasur
21 mundësinë për të udhëtuar në Kosovë, atëherë ju këshilloj që ta
22 bëni këtë në mënyrë që të vazhdoni hetimet tuaja.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Do ta bëj këtë, i nderuar Gjykatës.
24 Faleminderit.

25 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Von Bone.

1 Keni ndonjë gjë tjetër për të shtuar lidhur me hetimet?

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të ndërlidhem me atë që tha kolegu
3 im i nderuar.

4 Ne synojmë që ta finalizojmë, përfundojmë procesin e
5 nxjerrjes së dokumentacionit sa më shpejt që është e mundur. Ta
6 dorëzojmë dosjen paragjyqësore në datën që synojmë dhe të kalojmë
7 sa më shpejt që është e mundur në fazën e ardhshme të procedurës
8 që është vetë gjykimi.

9 Në qoftë se marrim parasysh datën e përafërt që dha kolegu
10 im, nëntë muaj për hetime, pra, për ne kjo është pak shqetësuese.
11 Ne e kemi të qartë se Mbrojtjes i duhet kohë për të kryer hetimet
12 e veta, por ndoshta duhet edhe të gjejmë një mënyrë sesi ta
13 trajtojmë këtë çështje.

14 Pra, duhet ta vlerësojmë masën e ndikimit të masave lidhur me
15 pandeminë që merr qeveria holandeze. Në çfarë mase, pra, ato do të
16 ndikojnë në mundësinë e Mbrojtjes për të udhëtuar në Kosovë për të
17 kryer hetimet e veta.

18 Këtë po e them sepse kemi në paraburgim të pandehurin dhe
19 duhet të vazhdojmë sa më shpejt që është e mundshme me gjykimin e
20 çështjes, dhe ky është jo vetëm detyrimi i Prokurorisë por edhe i
21 Mbrojtjes.

22 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

23 Z. Von Bone, unë e kam të qartë nevojën që duhet të kryeni
24 hetime, por ju inkurajoj që këto t'i bëni sa më shpejt që është e
25 mundur. Ne si një tribunal ndërkombëtar kemi mundësinë që të

1 marrim përjashtime nga këto kufizime lidhur me udhëtimet. Ka
2 gjithashtu mundësi për të kryer hetime nga distanca kur është puna
3 për qasje në disa dokumente.

4 Ne do t'i diskutojmë këto në seancën tjetër që do ta
5 organizojmë, kur do ta diskutojmë datën për Konferencën e Statusit
6 në të ardhmen, dhe është e qartë se atëherë do ta keni parasysh
7 sesa mund të zgjasin hetimet tuaja.

8 Tani do të doja që të dëgjoja palët sa i takon pikave
9 juridike dhe/ose faktike me të cilat janë pajtuar palët. Dhe dua
10 që të dëgjoj palët lidhur me këtë gjë, siç parashikohet në
11 rregullën 95(3) dhe 156 të Rregullores. Në qoftë se nuk keni
12 ndonjë gjë për të thënë ende, do të doja t'ju kërkoja të
13 shpreheshit se kur mendoni se do të jeni në gjendje që të
14 identifikoni një listë të çështjeve që janë objekt
15 mosmarrëveshjes.

16 Z. Prokuror, fjala për juve.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Z. Prokuror //siç u përkthye// do
18 t'i trajtoj të dyja çështjet bashkë, në qoftë se më lejoni.

19 Në përputhje me udhëzimet tuaja, ne jemi angazhuar në
20 diskutim me Mbrojtjen për sa i takon pikave juridike dhe faktike
21 që janë pjesë e marrëveshjes ndërmjet palëve. Dhe i kemi diskutuar
22 këto çështje me anë të telefonit të enjten që shkoi, dhe do ta
23 vazhdojmë edhe më tej këtë diskutim edhe gjatë javës në vijim.
24 Kemi planifikuar që të organizojmë një videokonferencë të shkurtër
25 lidhur me këtë çështje.

1 Megjithatë, pavarësisht kësaj, në fillim të vitit që vjen
2 Prokurori, Prokuroria do të përgatisë një listë çështjesh, apo
3 pika juridike dhe/ose faktike që Prokuroria dëshiron t'i kërkojë
4 Mbrojtjes që të shqyrtojë dhe mundësisht të bjerë dakord, që të
5 pajtohen. Pra, ne do të angazhohemi në diskutime dhe Prokuroria në
6 mënyrë proaktive do të përgatisë, do të përpilojë një listë pikash
7 që do të donin që të kishim pajtueshmërinë nga Mbrojtja.

8 Afati kohor që kemi parashikuar është data 15 janar,
9 tentativë -- në tentativë e vitit që shkon //siç u përkthye//, por
10 mbase mund të kemi mundësi që këtë listë mund t'ia japim Mbrojtjes
11 edhe përpara këtij afati kohor. Faleminderit.

12 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

13 Z. Von Bone.

14 Z. VON BONE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, është një çështje
15 e komplikuar nga pikëpamja e Mbrojtjes, në kuptimin që personi i
16 akuzuar, z. Mustafa ka luftuar për çlirimin dhe për lirinë e
17 Kosovës. Kështu që në përgjithësi më duhet të them që është e
18 vështirë që të biem dakord për pikat juridike apo pikat faktike.
19 Dhe sa i takon çështjes kryesore, që çështja është në qoftë se në
20 ndonjë pikë të caktuar mund të shohim që pjesë të caktuara të
21 faktit, apo pjesë të caktuara, pika të caktuara juridike, mund të
22 biem dakord ndërmjet palëve në mënyrë që të mund të përshpejtohet
23 procesi gjyqësor.

24 Dua të risiguroj nga ana e të akuzuarit, që z. Mustafa është
25 pa diskutim në situatën që pse ndodhem këtu, pse jam i akuzuar.

1 "Pse jam në këtë gjendje, ndërkohë që nuk kam bërë gjë tjetër
2 veçse kam luftuar për pavarësinë dhe për çlirimin e Kosovës?"

3 Për këtë pjesë, i nderuar Gjykatës, pra, pa diskutim, siç u
4 tha edhe me të drejtë nga Prokurori, kam marrë një telefonatë nga
5 Prokurori të enjten që shkoi, dhe kemi rënë dakord që do të
6 vijojmë me diskutimin dhe me shkëmbimin, për të parë në qoftë se
7 mund të biem dakord për pika juridike dhe/ose faktike apo jo. Dhe
8 në qoftë se kjo nuk është e mundur, atëherë për sa i takon datës
9 15 janar, nuk e di sesa do të respektohet ky afat kohor, por
10 gjithsesi do të punojmë për këtë çështje dhe do të shohim se deri
11 ku mund të arrijmë. Dhe do të shohim në qoftë se do të biem dakord
12 për pika juridike dhe faktike.

13 Pra, kemi punuar me një tabelë, d.m.th., mbyllja ose jo,
14 d.m.th., nuk është se të ndihmon, kështu që do të vijojmë me
15 diskutimet me ZOOM apo me ndonjë platformë tjetër. D.m.th., kështu
16 do të vazhdojmë më tej, dhe qëllimi, synimi është që ta
17 përfundojmë këtë listë sa më shpejt të jetë e mundur.

18 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë z. Von Bone.

19 Siç e thatë me të drejtë z. Von Bone, pra, ky është një hap
20 shumë i rëndësishëm për t'u përgatitur për procesin gjyqësor, pasi
21 është një proces i cili do t'u lejojë të dyja palëve dhe Trupës
22 Gjykuese që të përqendrohen te pikat më të rëndësishme. Edhe pse
23 z. Mustafa ndoshta s'është dakord me pjesën më të madhe, ose me të
24 gjitha faktet, gjithsesi ekziston mundësia që të bihet dakord për
25 pjesën e pikave juridike. Kështu që do t'ju inkurajoja që të

1 vazhdoni bashkëpunimin me Prokurorinë dhe të më dorëzonit një
2 listë në javët në vijim.

3 Prokuroria, keni ndonjë gjë tjetër për të shtuar?

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo. Jo në këtë pikë
5 domosdoshmërisht, por do të doja të theksoja që ne do të vazhdojmë
6 që të respektojmë këtë listë pikash, faktesh, dhe pastaj do të
7 varet nga niveli në të cilin Mbrojtja do të jetë dakord me këto
8 pika apo jo. Faleminderit.

9 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

10 Z. Von Bone, ndonjë gjë tjetër për të shtuar?

11 Mirë atëherë, le të vazhdojmë te pika tjetër e programit për
12 sot, dhe pika tjetër ka të bëjë me hapat pasues proceduralë. Do të
13 doja t'i kthehesha Mbrojtjes së pari.

14 Z. Von Bone, a mund të na thoni në qoftë se parashikoni që të
15 dorëzoni një dosje paragjyqësore dhe materiale të tjera të lidhura
16 në përputhje me rregullën 95(5) të Rregullores, dhe në qoftë se
17 po, a mund të na thoni se kur do të jeni në pozitën që të dërgoni
18 -- të na dorëzoni një dosje paragjyqësore të tillë?

19 Z. VON BONE: [Përkthim] I nderuar z. Gjykatës, nuk e kemi
20 përcaktuar akoma këtë gjë, kështu që nuk mund t'ju jap një
21 përgjigje lidhur me këtë pyetje, nuk jap dot një datë lidhur me
22 çfarë më pyetët.

23 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Von Bone.

24 Për Konferencën e radhës së Ecurisë së Çështjes, do të donim
25 vërtet z. Von Bone, që të ishit në gjendje që të na jepnit një

1 përgjigje në mënyrë që të mund të përgatitemi për hapat pasues,
2 dhe në veçanti të përgatitemi për gjyqin.

3 Tani do të doja t'u kërkoja palëve që të më thonë se kur
4 mendojnë që janë gati që të fillojë procesi gjyqësor, sepse në
5 përputhje me rregullën 95(2), mua më duhet që të përcaktoj një
6 datë të synuar për gatishmërinë për të filluar procesin gjyqësor.

7 Sigurisht që nuk do të biem dakord për një datë për procesin
8 gjyqësor sot, por do të doja që palët të më jepnin një lloj
9 indikacioni, një lloj ideje se kur mendojnë se dosja gjyqësore do
10 të jetë e gatshme për t'u transmetuar për Trupin Gjykses.

11 Prokuroria.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Zyra e Prokurorit të Specializuar,
13 dhe në fakt unë e përmenda dhe më parë, që në fillim të kësaj
14 Konference, që ne jemi gati që të përgatitemi për proces gjyqësor,
15 pra, dosja jonë paragjyqësore është gati, dhe i kemi përgatitur
16 dokumentet të cilat janë të parashikuara në rregullën 94(5). //siç
17 u përkthye// Pra, parashikojmë që dosja të jetë gati në janar, më
18 datë 5 -- në shkurt, më datë 15 shkurt të vitit 1999 -- të vitit
19 2021, dhe shpresojmë që procesi gjyqësor të mund të fillojë sa më
20 shpejt të jetë e mundur, mundësisht në mars të vitit që vjen.

21 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit.

22 Z. Von Bone, fjala për ju.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Por në fakt varet nga sasia e
24 dëshmitarëve që duam që të jenë pjesë e procesit gjyqësor. Por
25 është një çështje të cilën ne, po e kemi aktualisht, d.m.th., një

1 çështje me të cilën po përballemi. Do të shohim nëse do të jetë e
2 mundur ta bëjmë këtë gjë përpara muajit mars të vitit që vjen,
3 pra, të 2021-it. Nuk jam i sigurt për t'ju dhënë një përgjigje
4 specifike tani, por më duhet të them që po punojmë për të qenë më
5 të qartë.

6 Në vlerësimet e mia të përafërta, dua të them që ndoshta nuk
7 mund të jetë marsi, mund të jetë ndoshta një muaj ose gjashtë javë
8 pas marsit. D.m.th., këtë lloj indikacioni, këtë lloj date të
9 përgjithshme mund të jap, sepse dhjetori thuajse përfundoi dhe
10 ndërkohë që nuk mendoj që në këtë muaj ne të jemi -- të kemi
11 mundësi që të punojmë mbi këtë çështje. Sepse Krishtlindjet po
12 afrohen, janë dhe festat e fundvitit, kështu që thuajse dhjetori
13 ka përfunduar në kuptimin e asaj çfarë ka mbetur për të punuar.

14 Dhe do të punojmë bashkërisht me dëshmitarët, dhe do të
15 punojmë dhe do të mundohem që t'ju jap një ide më të qartë në një
16 pikë tjetër, në një kohë tjetër.

17 Meqenëse ra fjala, i nderuar z. Gjykatës, në qoftë se unë kam
18 ndonjë datë më të hershme, pa diskutim që do të bëj parashtrime
19 lidhur me të në mënyrë të tillë që të gjithë të informohen, pasi
20 mendoj që është më e thjeshtë për të gjitha palët për të pasur një
21 kalendar, ose një lloj agjende më specifike. Megjithatë d.m.th.,
22 nuk mund t'ju them një datë sepse varemi nga palët e treta lidhur
23 me këtë çështje. Faleminderit.

24 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Von Bone.

25 Tani dua t'i pyes palët në qoftë se ka ndonjë çështje tjetër

1 që ndonjëra nga palët dëshiron që të ngrejë.

2 Prokuroria, fjala për juve.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës, nuk kemi
4 pika të tjera.

5 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Z. Von Bone.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës, nuk mendoj se
7 kemi pika të tjera për të ngritur.

8 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit.

9 Në fund, z. Prokuror, a keni ndonjë parashtim lidhur me
10 datën e Konferencës së katërt për Gjendjen e Çështjes?

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Prokurori nuk ka një preferencë për
12 datën e ardhshme të Konferencës. Mund të jetë janar, mund të jetë
13 shkurt, d.m.th., varet nga nevojat edhe preferencat e Mbrojtjes.
14 D.m.th., mund të jetë ose në janar ose në shkurt, për ne nuk ka
15 problem.

16 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit Prokuroria.

17 Z. Von Bone.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Ne kemi pak preferencë që seanca
19 tjetër të realizohet në shkurt 2021.

20 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Von Bone.

21 Z. Von Bone, a ka ndonjë piketë specifike të rëndësishme që
22 do të donit të trajtohej përpara Konferencës për Gjendjen e
23 Çështjes? D.m.th., në veçanti e kam fjalën për vendimin kuadër për
24 nxjerrjen e materialeve. Kështu që do të doja t'ju pyesja në qoftë
25 se ka ndonjë hap procedure që do të donit ta hidhnit për sa i

1 takon mundësisë për të vijuar më tej me Konferencën për Gjendjen e
2 Çështjes?

3 Z. VON BONE: [Përkthim] Siç u shpreha më përpara, d.m.th., ka
4 pasur një listë të gjatë gjërash që unë do të doja që të
5 qartësoheshin, të sqaroheshin nga Prokuroria. Mendoj se kjo do të
6 kërkojë pak më shumë kohë sesa normalisht.

7 D.m.th., kam identifikuar 232 çështje nga kjo listë, dhe më
8 duhet të them që nuk është vetëm thjesht çështje e punës time, po
9 më duhet të diskutoj shumë materiale me klientin tim, me të
10 akuzuarin, dhe së bashku do të na duhet që të punojmë me këtë
11 çështje. Dhe në qoftë se nuk është e nevojshme, nuk është e
12 nevojshme, por gjithsesi ne besojmë, mendojmë për momentin që
13 është e nevojshme një punë më e kujdesshme lidhur me këto
14 dokumente.

15 Një tjetër gjë që do të doja të shqyrtoja dhe të ngrija,
16 është sesi dëshiron Gjykatësi që ne të komunikojmë me Prokurorinë?
17 D.m.th., mendoni që është më mirë që të dorëzojmë parashtime apo
18 të komunikojmë në mënyrë tjetër?

19 Pra, ne kemi një adresë e-maili - në fakt të dyja palët - ku
20 ne mund të shkëmbejmë informacion dhe mund të komunikojmë në
21 mënyrë të drejtpërdrejtë, ku mund të caktoj datën. Por unë mendoj
22 që do të jenë disa data që do të duhet të sqarohen dhe që do të
23 duhet të bien dakord ndërmjet palëve. Kështu që do të doja të dija
24 sesi mund të vijohet me komunikimin.

25 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Mund të komunikoni në mënyrë të

1 drejtpërdrejtë me Prokurorinë, mbështetur në vendimin kuadër,
2 kështu që ju lutem mos hezitoni, komunikoni në mënyrë të
3 drejtpërdrejtë me Prokurorinë lidhur me sa përmendët më sipër.

4 Së fundi, do të doja që të thosha që pushimi në Gjykatë
5 fillon më datë 21 dhjetor 2020 dhe përfundon më datën 1 janar
6 2021. Gjatë kësaj periudhe kohore do të kem mundësi t'i përgjigjem
7 vetëm çështjeve urgjente, kështu që çështjet që nuk janë urgjente
8 duhet që t'i drejtohen Gjykatës Themelore ose para, ose pas
9 pushimit.

10 Kemi arritur në përfundim të seancës së ditës së sotme.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni z. Gjykatës,
12 një koment të fundit.

13 Unë kam takime me klientin tim. Janë kryesisht takime të
14 cilat organizohen përmes ZOOM-it, janë takime që nuk zgjasin më
15 shumë sesa një orë përgjithësisht. Sigurisht që kjo nuk është
16 mënyra normale e të punuarit, sepse me një çështje, me një dosje
17 të tillë kaq të madhe, d.m.th., i takon që të punosh me klientin
18 gjithë ditën, dhe jo të mjaftohesh vetëm me një orë. Kështu do të
19 doja t'ju kërkoja që të mundësoheshin ndoshta diskutime më të
20 gjata me klientin tim, jo vetëm diskutime prej një ore, sepse do
21 të ishte shumë herë më e thjeshtë për ne për të punuar bashkërisht
22 me dosjen dhe me materialet e përfshira në të.

23 Dhe shpresoj që në një pikë të caktuar kohe Zyra e
24 Administratës, Administrimit këtu dhe personat përgjegjës të mund
25 të na mundësojnë, le të themi, komunikim më të gjatë sepse në të

1 kundërtën, siç e thashë edhe më sipër, takimet janë të
2 pamjaftueshme. Kemi vetëm dy takime në javë dhe diskutojmë pak a
3 shumë një orë me njëri-tjetrin. Varet nga java, gjërat mund të
4 ndryshojnë nga njëra javë te tjetra, por sa i takon pjesës së
5 organizimit dhe kohëzgjatjes së takimeve, d.m.th., përgjithësisht
6 ja është Zyra këtu, Zyra përkatëse e cila vendos. Kështu që do të
7 doja t'ju kërkoja në qoftë se do të ishte e mundshme që të
8 takoheshim më shpesh gjatë javës dhe që takimet të ishin më të
9 gjata. Faleminderit.

10 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Von Bone. Nuk e
11 di e keni trajtuar këtë çështje me Zyrën e Administratorit të
12 Gjykatës, apo vetëm me DMU-në? A e keni trajtuar me Paraburgimin
13 apo thjesht me Zyrën e Administrimit të Gjykatës?

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, e kuptoj që ka të ndaluar të
15 ndryshëm. Por për shkak të situatës së COVID-it e kuptoj
16 pozicionin e të gjithëve edhe mundësive apo pamundësitë e të
17 gjithëve. Kështu që më duhet të them që pa diskutim që situata
18 është tërësisht ndryshe në qoftë se ti shkon normalisht, fizikisht
19 te qendra e burgimit, qëndron gjithë pasditen p.sh., edhe mund të
20 punosh për disa orë me të akuzuarin, ndërkohë që tani mundësitë
21 janë të kufizuara. Ti ke kohë të kufizuar, ke shumë çështje për të
22 mbuluar, kështu që në përgjithësi do të doja të thosha që çështja
23 bëhet më e komplikuar, jeta të bëhet më e komplikuar kështu.

24 Kështu që e vetmja gjë që do të kërkoja ishte nëse do të
25 ishte e mundur të mund të takohesha pak më gjatë me klientin tim.

1 Nuk e di se kush mund të ndërhyjë, po kushdo që do të ndërhynte do
2 t'i isha mirënjohës. Faleminderit.

3 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Von Bone. Do të
4 doja që ta përmendnit në momentin kur të planifikoni takimin me
5 Njësinë e Paraburgimit, dhe të shpreheni që keni nevojë për kohë
6 më shumë në dispozicion në mënyrë që takimet të jenë më produktive
7 me klientin tuaj. Dhe në qoftë se ka probleme, ka çështje që
8 ngrihen prej tyre, pa diskutim që do ta trajtojmë këtë çështje në
9 Konferencën e ardhshme, por shpresoj që të keni mundësi që këtë
10 çështje të mund ta zgjidhni në mënyrë të drejtpërdrejtë me Njësinë
11 e Paraburgimit.

12 Ndonjë gjë tjetër a keni për të thënë?

13 Mirë atëherë, në qoftë se jo jemi në fund të procesit të
14 ditës së sotme. Dua të falënderoj sekretaret, dua të falënderoj
15 gjithashtu edhe përkthyesit, stenografët, teknikët edhe personelin
16 e sigurisë. Mbyllet seanca këtu.

17 --- Konferenca për Ecurinë e Çështjes përfundon në orën 16.07

18

19

20

21

22

23

24

25